



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12,14.2 ,17 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 3 pika 1.4 , neni 6 pika 1.2 , neni 8 pika 1.3 dhe neni 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 nenit 44.1 dhe 47.3 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016 dhe neni 39 i Rregullorës së Punës së Kuvendit nr.I-95,dt.29.06.2018 dhe propozimet e Kryetarit të Komunës nr. II-31,dt:22.01.2021 dhe propozim vendimi i Kryetarit të Komunës nr.II-32dt.26.01.2021, kërkesa e MPL-se nr VI-020/107-4,dt.22.02.2021, 23.03.2021 Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajturë më datë 23.03.2021 mori këtë

VENDIM
PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË
PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN
KADASTRALE NË LLAZAREVË

I

Miratohet Vendim për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës , në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit “ NIC HOME SH.P.K ” me adresë :Milloshevë-Obiliq

II

Sipas pikes I të këtij vendimi :

1. “ NIC HOME SH.P.K ” është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës
2. Pronat e Komunës gjenden në zonën kadastrale Llazarevë Njësia Kadastrale si në vijim P-72614041-00124-20 , me sipërfaqe të përgjithshme prej 13969 m², Vend i quajtur “Harëdhia” zone-Rrurale, zk.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela është Zonë Industriale, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të P.SH.KK OBILIQ . Sipas nenit 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092
- 3 .Shfrytëzimi i pronës do të jetë për 99 vjet nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi , pas përfundit të këtij afati pronat i kthehen titullarit .

4 .Në pronën e paluajtëshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të “ NIC HOME SH.P.K ”

III

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtëshme të cekur në pikën II , bëhet me kompenzim

IV

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shrytëzuesit të pronave të paluajtëshme të Komunës

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorati për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër, Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

VI

Obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtëshme të Komunës të regjistron në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit

Nr. I- 56 - , më 23 Mars 2021

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- MPL
- DPUKP
- DMM
- DEZHF
- DI
- Palës
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri

Burim Gërguri

Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Nr. 020-107/19
 -VI-
 Data 22.02.2021



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 • Ministria e Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government

Për:	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 16.02.2021 Nr.020-107
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
	2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Obiliqit	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim përfundimtar i Kuvendit të Komunës Nr. I - 17 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë - "NIC HOME SH.P.K"
I miratuar më datë: 29.01.2021
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 05.02.2021

11 -
 6 -

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Vendim përfundimtar i Kuvendit të Komunës Nr. I - 17 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë - "NIC HOME SH.P.K"	<p>Vendim përfundimtar i Kuvendit të Komunës Nr. I - 17 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë "NIC HOME SH.P.K" është në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës përkatësisht me pikat 6.2, 6.4 dhe 6.6 të paragrafit 6 të nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ku ceket se:</p> <p><i>"Pas negociimit të ofertës, kryetari i komunës i propozon kuvendit të komunës të miratoj vendimin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke i bashkangjitur dokumentet përcjellëse, si:</i></p> <p>6.2 <i>Ofertën e negociuar, për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;</i></p> <p>6.4 <i>Projekti i paraqitur nga investitori dhe plani dinamik i realizimit të investimit;</i></p> <p>6.6 <i>Certifikatën e regjistrimit të biznesit, vërtetim që nuk ka obligime tatimore, qarkullimi bankar për vitin paraprak.</i></p> <p>Në rastin konkret Vendimit i mungon oferta e negociuar, projekti i paraqitur dhe plani dinamik i realizimit të investimit nga investitori, vërtetimi që nuk kanë obligime tatimore si dhe qarkullimi bankar për vitin paraprak.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Obiliqit që të ndër marrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.